

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Analizat e biznesit

P11

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Problemi 1

Narta shpk është një biznes i diversifikuar i formuar përmes bashkimit të Noli Elektriika dhe Teknologjia Blendi në 1990. Narta është kompania mëmë për shumë filiale në sektorë të ndryshëm të industrisë duke përfshirë sigurimet, shërbimet financiare, prodhimin e veshjeve, bujqësinë dhe plehtrat.

Kompania është duke ndërmarrë një rishikim strategjik të tre prej filialeve të saj: Ferma Skozi, Sigurimet CB dhe Pato Teknologji. Të dhënat për tre kompanitë janë dhënë për këtë rishikim, siç tregohet në Figurën 1.

	2014	2015	2016
	€m	€m	€m
Ferma Skozi			
Shitjet/qarkullimi	102	97	90
Fitimi bruto	12	7	4
Qarkullimi i tregut	550	530	512
Sigurimet CB			
Shitjet/qarkullimi	70	84	93
Fitimi bruto	20	25	22
Qarkullimi i tregut	810	850	890
Pato Teknologji			
Shitjet/qarkullimi	50	58	69
Fitimi bruto	20	23	28
Qarkullimi i tregut	330	360	400

Figura 1 - Të dhëna financiare për tre filiale 2014–2016

Ferma Skozi - kjo ishte blerja e parë e Nartës në 1994. Narta shpk kishte qenë një histori suksesi në zhvillimin e teknologjisë së viteve 1990 dhe kishte tepriçë parash dhe një numër aksionarësh kërkonin rritje në vlerën e aksioneve të tyre. Në vitin 1994, industria e bujqësisë u përball me një numër kërcënimesh dhe Ferma Skozi u ble në mënyrë të volitshme që konsiderohej të ishte me çmim të ulët të blerjes.

Në kohën e blerjes, bordi i Narta shpk ishte i vetëdijshëm se ata kishin pak njohuri për industrinë e bujqësisë, por mendonin se menaxherët e Fermës Skozi ishin të aftë dhe thjesht kishin nevojë për inkurajim. Ata ofruan stimuj financiarë për performancë të mirë dhe siguruan burime financiare për të ndihmuar në rritjen e filialit. Kjo fillimisht funksionoi mirë, por performanca e ndërmarrjes filloi të bjerë në 2010 dhe Narta ndaloi së ofruari burime financiare, pasi ata menduan se nuk po përdoren për të shtuar vlerë.

Në vitin 2016, konkurrenti më i afërt i Fermës Skozi kishte 15.4% të tregut.

Sigurimet CB - kjo u ble në 2011 pasi Narta shpk njohu zhvillimin e shpejtë të industrisë së sigurimeve në tregun e vendit të vet dhe gjithashtu marzhet e larta që fitohen, ishin ato që shtyen blerjen e kësaj kompanie. Sigurimet CB ishin të listuar rishtazi në tregun e aksioneve dhe bordi i Narta kishte angazhuar një broker për të blerë aksione në emër të saj, në mënyrë që të fitonte kontrollin mbi këtë kompani. Narta justifikoi veprimet e saj pasi çmimi i aksionit u rrit me shpejtësi pas blerjes.

Sigurimet CB ka vazhduar të rritet me pak përfshirje nga Narta shpk, por tani po lufton për të menaxhuar rritjen e saj, duke mos arritur të rekrutojë staf të ri të mjaftueshëm ose të sigurojë hapësirë të mjaftueshme për zyra për të përballuar operacionet e saj në rritje. Ajo operon në një industri ku ka relativisht pak firma më të mëdha dhe qindra kompani të vogla dhe ku lideri i tregut mban 12% të tregut. Ekonomia në të cilën operon kjo kompani po rritet me një normë prej afërsisht 2% çdo vit.

Pato Teknologji - kjo është blerja e fundit, që ka ndodhur në 2014. Kompania prodhon pajisje elektronike të konsumit, të ngjashme me të dy kompanitë themeluese të Narta. Ajo operon në një vend tjetër ku industria sapo ka filluar të zhvillohet dhe rritet, ashtu siç bëri për Narta në vitet 1990. Narta ka filiale të tjera të vendosura në këtë vend. Menaxhmenti i Pato Teknologji kanë shumë njohuri për klientët dhe industrinë e tyre dhe kompania ka një markë të mirë mjaft shumë të njohur. Konkurrenti i tij më i afërt ka pjesën e tregut prej 8%.

Kërkohet:

(a) Analizoni pozicionin financiar të secilës kompani (Ferma Skozi, Sigurimet CB dhe Pato Teknologji) në portofolin e Narta shpk. Analiza juaj duhet të përfshijë shqyrtimin e pozicionit të secilës kompani brenda matricave BCG dhe Ashridge dhe duhet të sugjerojë një strategji të përshtatshme për secilën filial si rezultat i analizës suaj. (18 pikë)

Menaxherët e portofolit, menaxherët e sinergjisë dhe zhvilluesit prind janë tre arsyet e korporatave, të zhvilluara nga Johnson, Scholes dhe Whittington, për shtimin e vlerës në filialet nga shoqëria mëmë.

Kërkohet:

(b) Shpjegoni secilën prej këtyre arsyeve të ndara për shtimin e vlerës dhe sugjeroni se cila është ajo që ka më së shumti të ngjarë të jetë e duhur për Narta shpk. (7 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

(a) Ka shumë filiale brenda biznesit të diversifikuar të Narta shpk, por kjo përgjigje do të përqendrohet në tre skenare: Ferma Skozi, Sigurimi CB dhe Pato Teknologji.

Ferma Skozi

Ferma Skozi duket se ka performuar mirë deri në vitin 2010, kur filloi të binte. Kjo rënie duket se ka vazhduar, megjithëse kemi vetëm të dhënat e tre viteve të fundit. Tregu ka rënë 6.91% gjatë tre viteve (3.64% në 2014–15 dhe 3.4% në 2015–16). Jo vetëm që tregu ka rënë, por pjesa e tregut e Skozit gjithashtu po bie, nga 18.55% në 2014 në 17.58% në 2016. Kjo është si rezultat i rënies të qarkullimit prej 11.76% gjatë tre viteve. Rënia e Skozit duket se po rritet pasi kishte rënie shumë më të madhe të qarkullimi (7.22%) në 2016 sesa në 2015 (4.9%).

Përkundër kësaj, Skozi ende duket të ketë një pjesë relativisht të lartë të tregut (18.55%), duke pasur parasysh pjesëmarrjen e konkurrencës më të afërt prej 15.4% dhe kështu, me rënien e tregut dhe pjesën e lartë të tregut, mund të konsiderohet si filiale e cilat sjell para në matricën BCG (lopa). Nëse pjesa e tregut e Skozit vazhdon rënien e saj, ai mund të bëhet filiale e cila ka pjesë të vogël të tregut në matricën BCG (qeni), pasi konkurrenti më i afërt mund ta tejkalojë atë.

Filialet të cilat sjellin para në matricën BCG (lopa) me qenë se gjenerojnë fitime të larta, nevojiten shpenzime të ulëta të marketingut ose zhvillimit të produkteve.

Sidoqoftë, marzhi i fitimit bruto të Skozit është më i ulët nga tre kompanitë e përmendura të Narta shpk: 11.76% (2014), 7.22% (2015) dhe 4.44% (2016). Rënia është e shpejtë, me fitimin absolut bruto që bie 66.67% gjatë tre viteve. Prandaj, mund të jetë koha të zhvendoset ky filial para se të fillojë të realizojë humbje, veçanërisht nëse stili i kompanisë mëmë i Narta është ai i menaxherit të portofolit (siç diskutohet në pjesën b).

Në të kaluarën, Narta i ka siguruar burime financiare Skozit, por nuk duket se ka kompetenca shtesë, duke qenë në një industri të teknologjisë me rritje të lartë. Prandaj, ndoshta ka aftësi të kufizuar për të shtuar vlerë.

Ky përfundim mbështet gjithashtu sugjerimin për të zhvendosur biznesin, pasi nuk ka gjasa që të fitohet ndonjë vlerë me mbajtjen e tij. Narta do të përqendronte më mirë vëmendjen e saj në filiale të cilat mund të sjellin vlera të mëtejshme.

Sigurimi CB

Sigurimi CB është blerje rishtazi në portofol, i cili u rrit me shpejtësi në kohën e blerjes dhe duket se ka mbajtur me sukses rritjen në qarkullim dhe pjesën e tregut që nga blerja. Qarkullimi u rrit me 20% në 2015 dhe me 10.71% në 2016, duke dhënë një rritje të shpejtë prej 32.86% gjatë tre viteve. Duke vepruar kështu, pjesa e saj e tregut u rrit nga 8.64% në 10.45% gjatë së njëjtës periudhë kohore, duke treguar që Sigurimi CB po rritet me një ritëm më të shpejtë se tregu. Sidoqoftë, vetë tregu vazhdon të rritet me qarkullimin e tregut që rritet me 9.88% gjatë tre viteve të fundit.

Meqenëse rritja e ekonomisë në të cilën operon Sigurimi CB është 2%, kjo mund të konsiderohet një industri me rritje relativisht të lartë. Pjesa e tij e tregut prej 10.45%, edhe pse e mirë, nuk është aq e lartë sa udhëheqësi i tregut, me 12%. Prandaj, kjo mund të konsiderohet një biznes me një pjesë të vogël të tregut në një industri që rritet me shpejtësi (fëmijë problematik në matricën BCG). Sidoqoftë, nëse Sigurimi CB vazhdon me rritjen e saj të shpejtë, ajo mund të bëhet lider në treg dhe kështu të kalojë në pozicionin yll në matricën

BCG.

Kur merret parasysh matrica Ashridge, ekziston qartë një mundësi për të shtuar vlerë; tregu po rritet dhe CB ka nevojë për ndihmë për ta ndihmuar atë të vazhdojë të përfitojë nga rritja. Marzhi i fitimit të saj po bie (nga 28.57% në 2014 në 23.66% në 2016) dhe mund të ketë një mundësi për ta përmirësuar këtë. Narta shpk mund të mos ketë njohuri për vetë tregun dhe për këtë arsye ka mungesë të kompetencave në industri, por ka përvojë të rritjes së shpejtë dhe gjithashtu ka qasje në burimet që mund të vihen në dispozicion. Kjo mund ta bëjë Sigurimin CB “biznes zemër” sipas matricës Ashridge.

Të dy pozicionet në matricat BCG dhe Ashridge sugjerojnë që Narta duhet të investojë në këtë biznes për të ndihmuar në shtimin e vlerës. Meqenëse pjesa e tregut është vetëm

1.55% nën udhëheqësin e tregut, një strategji e mirë në këtë situatë do të ishte që Narta të investonte në CB që të përpiquej të rrisë më tej pjesën e saj të tregut dhe të bëjë një kompani yll në matricën BCG. CB ka thënë se ata po luftojnë për të ecur me rritjen, kështu që sigurimi i financave për ambientet e reja dhe rekrutimi i stafit do të ishte me përfitim. Mund të jetë që Narta mund të jetë në gjendje të njohë stafin e aftë të duhur nga biznesi i shërbimeve financiare të Narta, i cili mund të zhvendoset përkohësisht ose përgjithmonë te CB.

Pato Teknologji

Kjo është blerje e re, por duket se po sjell përfitime për Narta shpk. Qarkullimi i kësaj kompanie është rritur 16% në vitin e parë pas blerjes dhe është rritur 18.97% nga 2015–16. Ajo ka marzhën e fitimit bruto më të lartë se filialet e tjera të përmendura në këtë skenar dhe ka ruajtur të njëjtin nivel në rreth 40% në secilën prej tre viteve të fundit. Në të vërtetë, megjithëse më e vogël se dy filialet e tjera në qarkullim, ajo siguron një fitim bruto absolut më të lartë se të dyja të kombinuara në 2016.

Tregu gjithashtu po rritet me shpejtësi, një rritje prej 21.21% gjatë tre viteve. Pato Teknologji po rritet më shpejt se tregu, me pjesën e saj që është rritur nga 15.15% në 17.25% gjatë së njëjtës periudhë. Kjo mbështet pretendimin se menaxherët ekzistues kanë njohuri për klientët dhe tregun. Konkurrenti tjetër më i lartë ka një pjesë të tregut prej 8%, më pak se gjysma e Pato Teknologjisë.

Në matricën BCG, kjo do të ishte një kompani yll. Matrica sugjeron nevojën për të ndërtuar më tej për të ruajtur pozicionin e saj të yllit dhe për të qenë një lider dominues i tregut kur tregu përfundimisht ngadalësohet.

Duke parë matricën Ashridge, Narta ka njohuritë e kërkuara për të qenë në gjendje t'i shtojë vlerë kësaj kompanie. Sidoqoftë, mundësia e tyre për të shtuar vlerë mund të jetë e vogël pasi kompania tashmë po performon mirë dhe ka një emër të mirë marke. Kështu, Pato Teknologji mund të konsiderohet një “biznes i papajtueshëm”. Matrica sugjeron që këto të lihen vetëm për të ekzekutuar vetë, pasi ndërhyrja mund të zvogëlojë vlerën.

Kështu sugjerohet që Narta të linte Pato Teknologjinë të drejtohet në mënyrë autonome dhe të jetë e hapur për sigurimin e burimeve, nëse kërkohet në të ardhmen, për të ndihmuar në ndërtimin e biznesit më tej.

(b) Narta është biznes i diversifikuar me shumë filiale. Kompanitë që diversifikojnë në këtë mënyrë zakonisht kanë një arsyetim të planifikuar të korporatave për ta bërë këtë, i tillë që të

gjitha blerjet të përshtaten me zhvillimin strategjik të kompanisë mëmë. Johnson, Scholes dhe Ēhittington identifikuan tre arsyeshmëri të tilla të korporatave: menaxherë të portofolit, menaxherë të sinergjisë dhe zhvillues prind.

Menaxherët e portofolit

Këto kompani mëmë kërkojnë kompani të nënvlerësuara për t'i shtuar portofolit të tyre. Prindi, zakonisht, është një kompani e shumëllojshme, e konglomeratit. Filialet e ndryshëm mund të jenë në industri krejtësisht të palidhura. Kompania mëmë ka tendencë të lejojë blerjet të mbeten autonome, duke pasur parasysh mungesën e sinergjive midis kompanive, por vendos objektiva financiarë për të siguruar që performanca të përmirësohet dhe vlera të shtohet.

Menaxherët e sinergjisë

Kompanitë mëmë që veprojnë si menaxherë të sinergjisë kërkojnë ekonomi të fushës ose sinergji midis kompanive të ndryshme brenda grupit. Ata do të njohin se ku mund të ndahen burimet dhe kompetencat midis filialeve dhe, si të tilla, shpesh ekziston lidhje midis kompanive filiale, p.sh. ato mund të jenë në faza të ndryshme të të njëjtit zinxhir furnizimi.

Megjithëse Narta duket se ka disa kompani të lidhura me njëra-tjetrën (p.sh. bujqësia dhe plehrat), nuk ka asnjë tregues nga skenari që aktualisht i inkurajon këto të punojnë së bashku ose të ndajnë burimet. Prandaj nuk ka gjasa që të jetë menaxher i sinergjisë. Sidoqoftë, nëse duhet të merren këshillat në lidhje me Sigurimin CB (lëvizja e stafit midis kompanive), atëherë mund të fillojë të aprovojë disa nga parimet e menaxhimit të sinergjisë.

Zhvilluesit prind

Zhvilluesit prind kërkojnë filiale të cilat ajo mund të përdorë kompetencat e veta për të përmirësuar dhe shtuar vlerën. Për shembull, Narta mund të përdorë njohuritë e saj për të qenë në një treg në rritje të elektronikës të konsumit, ose për të operuar në të njëjtin vend, për të ndihmuar Pato Teknologji.

Sidoqoftë, sugjerohet që Pato Teknologji, vetë, të ketë njohuritë e kërkuara për tu rritur më tej dhe për këtë arsye mund të mos ekzistojë mundësia që Narta të veprojë si një zhvillues prind.

Arsyeja e korporatës Narta

Narta shpk duket se ka të gjitha karakteristikat e një menaxheri të portofolit. Bizneset e tij të larmishme përfshijnë sigurime, bujqësi, prodhim veshjesh dhe pajisje elektronike të konsumit, të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me biznes dhe nuk ka gjasa të ndajnë shumë sinergji. Në të kaluarën ka vendosur objektiva financiarë për Fermën Skozi dhe ka tërhequr mbështetjen kur ato nuk janë përmbushur. Ai gjithashtu ka lejuar filialet të funksionojnë mjaft në mënyrë autonome, duke lënë ekipet e menaxhimit në vend.

Nënkuptohet gjithashtu që shumë nga filialet u konsideruan të nënvlerësuara gjatë blerjes; Ferma Skozi u ble 'për një çmim të ulët', Sigurimi CB ishte rishtazi i listuar dhe çmimet e aksioneve u rritën me shpejtësi pas blerjes dhe Pato Teknologji është në një treg rritjeje, duke sugjeruar se mund të ketë vlerë të mëtejshme për t'u shtuar.

Prandaj mund të argumentohet se Narta është një menaxher i portofolit.

Problemi 2

Një ndërmarrje botuese e gazetave, Delta Grupi Ndërkombëtar, po kalon nëpër rishikim të proceseve të saj të biznesit me qëllim përmirësimin e konkurrencës dhe performancës së saj financiare.

Kjo kompani tanimë ka vendosur të transferojë departamentin e brendshëm ligjor, i cili përdoret, siç kërkohet, rast pas rasti, ose për të mbrojtur kompaninë kur dikush sjell një padi kundër saj, ose për të kontrolluar nëse shkel ndonjë ligj kur publikon një artikull, duke marrë shërbime ligjore nga një kompani e jashtme.

Kompania beson se ky proces është vendimi i saktë, pasi kërkesa për punën është e rrallë dhe e paparashikueshme për këtë departament. Aktualisht ajo duhet të ruajë aftësitë e nevojshme ligjore brenda kompanisë, së bashku me financimin e trajnimit të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për t'i mbajtur ato aftësi të stafit të azhurnuara. Kompania beson se kontrata e jashtme do të jetë më e lirë dhe do të lejojë që të përdoret ekspertiza e duhur ligjore kur kërkohet.

Kompania ka identifikuar tre procese të tjera që mendon se kanë nevojë për rishikim:

Botim i gazetës ditore financiare

Kjo është marka kyçe në grupin Delta. Kompania krenohet me sigurimin e artikujve të detajuar të lajmeve financiare nga e gjithë bota. Artikujt që publikohen janë mjaft të lexuar midis profesionistëve të financave dhe drejtuesve të ndërmarrjeve. Sidoqoftë, popullariteti i gazetës ka qenë në rënie, me ankesa nga lexuesit e saj se asaj i mungon analiza dhe komenti i mjaftueshëm editorial i nivelit të lartë, në vend që thjesht të raportojë faktet. Lexuesit kanë sugjeruar që shumica e këtij informacioni tani mund të gjendet në internet, kështu që gazeta duhet të sigurojë diçka më shumë.

Procesi i botimit të gazetës përdor shumë reporterë, të cilët punojnë nga vende të shumta në të gjithë botën. Kur shpërthen një histori, redaktori i gazetës porosit një artikull nga reporteri më i afërt gjeografikisht. Këta reporterë punojnë për të gjitha gazetatat brenda Grupit Delta siç kërkohet dhe kështu nuk janë profesionistë të specializuar të financave. Gazetarët dërgojnë artikuj me email. Afatet për dorëzim janë të shpejta. Këto nënkuptojnë që anëtarët e redaksisë, përgjegjës për artikullin përfundimtar, shpesh nuk kanë kohë për të kontrolluar cilësinë e artikullit ose për të shtuar komente të nivelit të lartë.

Menaxhimi i abonentëve

Megjithëse Delta Grup ka një rrjet të gjerë shpërndarjeje, duke shitur gazetën ditore financiare dhe gazetatat e tjera përmes supermarketeve dhe shitësve të gazetave, shumica e të ardhurave të kompanisë vijnë nga abonentë të rregullt, të cilëve u shpërndahen gazetatat direkt. Abonentët menaxhohen nga një ekip i marrëdhënies me klientët të cilët operojnë nga zyra qendrore. Secili anëtar i ekipit është përgjegjës për një numër abonentësh. Nëse anëtar i duhur i ekipit është i padisponueshëm kur një abonent bën thirrje me pyetje, abonentit i kërkohet të telefonojë përsëri më vonë. Si rezultat i kësaj politike, një numër abonentësh janë larguar kohët e fundit dhe të ardhurat e kompanisë po bien. Pyetjet e abonentëve janë mjaft të thjeshta, siç janë faturimi i pasaktë ose çështjet e dorëzimit të gazetave.

Pagat

Grupi Delta ka një departament të brendshëm të pagave, i cili ka vështirësi të merret me shumëllojshmërinë e kushteve të pagesës për punonjësit e tij të ndryshëm. Disa reporterë paguhen në bazë të artikullit, ndërsa të tjerët paguhen me pagë të rregullt mujore. Për më tepër, ka pagesa bonusi për stafin nëse shitjet javore tejkalojnë shifrat e caktuara të synuara. Ka gabime të rregullta në këto pagesa dhe stafi, përfshirë reporterët, gjithnjë e më shumë po kalojnë kohë duke u përpjekur të zgjidhin këto gabime me departamentin e pagave.

Grupi Delta ka identifikuar tre fusha të procesit për përmirësim: botimi i gazetës ditore financiare, menaxhimi i abonentëve dhe pagat.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni secilën nga tre fushat e procesit të identifikuara më sipër duke përdorur matricën proces-strategji të Harmonit. Rekomandoni dhe arsyetoni strategji përmirësimi, për secilin nga tre proceset, e cila adreson problemet me të cilat përballet secili. (15 pikë)

Grupi Delta tashmë ka vendosur që proceset e tij ligjore të përmirësohen përmes kontraktimit të jashtëm.

Kërkohet:

(a) Shpjegoni disavantazhet dhe rreziqet që lidhen me kontraktimin e departamentit ligjor dhe diskutoni se si mund të menaxhohen këto rreziqe. (10 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

(a) Grupi Delta mund të vlerësojë përparësinë e tre proceseve në matricën e strategjisë së procesit të Harmonit. Matrica ka dy boshte. Boshti vertikal ka të bëjë me kompleksitetin e procesit. Kompleksiteti i ulët i procesit i referohet procedurave të thjeshta ose rutinë me pak inpute, ndërsa proceset tepër komplekse mund të konsiderohet se kanë nevojë për një nivel të lartë aftësie, të jenë jo-rutinë dhe të përdorin një larmi të inputeve të ndryshme.

Boshti horizontal merr në konsideratë rëndësinë strategjike të këtyre proceseve. Proceset me rëndësi të ulët kanë të bëjnë me gjërat që duhet të bëhen, por që u shtojnë pak vlera produkteve ose shërbimeve. Sidoqoftë, proceset me vlerë të lartë janë shumë të rëndësishme për suksesin dhe shpesh konsiderohen të jenë proceset thelbësore. Nga këto dy boshte, Harmon kategorizon katër kuadrantë dhe bën sugjerime se si duhet të trajtohen proceset në secilin kuadrant, siç është përmbledhur në Figurën 1.

Rëndësia strategjike

Lartë

Ulët

Kompleksiteti i procesit	Lartë	<p>Procese komplekse, dinamike, që dhe dinamike, por jo pjesë e kompetencave thelbësore</p> <p>BURIMI NGA JASHTE</p> <p>PERMIRËSIMI I PROCESIT FOKUSIMI TE NJERËZIT DHE NDËRVEPRIMET E TYRE</p>
	Ulët	<p>Procese të thjeshta-automatizim me sisteme jashtë raftit</p> <p>AUTOMATIZIM OSE BURIMI NGA JASHTË</p> <p>Procese të thjeshta por të rëndësishme</p> <p>AUTOMATIZIM</p>

Figura 1 - Matrica e Procesit / strategjisë së Harmonit

Secili prej tre proceseve mund të vlerësohet nga ana tjetër duke përdorur matricën, si më poshtë:

Botim i gazetës ditore financiare

Kjo duket të ketë një rëndësi të lartë strategjike për grupin, si dhe të një kompleksiteti të lartë. Skenari thotë se kjo është një nga markat kryesore brenda Grupit Delta, me emër të mirë të brendit. Mund të konsiderohet si biznes kryesor dhe për këtë arsye me rëndësi të lartë strategjike për grupin. Matrica sugjeron që ky proces të mbetet i brendshëm.

Procesi i botimit të kësaj gazete nuk mund të përcaktohet si i thjeshtë; kërkon staf të ditur me aftësi të mira komunikimi për të tërhequr lexuesit. Burimet janë të shumta dhe të larmishme, dhe obligimet për autorët nuk ka gjasa të jenë të përsëritura.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj gazete për grupin dhe rënien e fundit të lexuesve, është thelbësore që procesi të përmirësohet për ta përmirësuar situatën. Matrica sugjeron përmirësimin e procesit duke u përqëndruar te njerëzit. Ajo mund të jetë se Grupi Delta rekruton gazetarë të dedikuar të financave për të rritur përmbajtjen ose si alternativë trajnon stafin e vet të raportimit në aftësitë redaktuese. Sidoqoftë, duket se mund të përmirësohet mënyra në të cilën reporterët ndërveprojnë me gazetën. Nëse punimi do të prezantonte një verzion në internet, stafi i redaksisë mund të komentonte mbi artikujt e siguruar nga reporterët, edhe pas botimit të artikujve.

Menaxhimi i abonentëve

Ky është një proces relativisht i thjeshtë; ka të ngjarë të jetë i përsëritur dhe i drejtpërdrejtë për tu menaxhuar, me pak ndërhyrje në proces. Duke qenë se është një rrjedhë e rëndësishme e të ardhurave për Grupin Delta, ai duhet të sigurojë që procesi të jetë i efektshëm dhe t'i përshtatet nevojave të abonentëve. Kjo duhet të adresojë rënien e abonentëve, së bashku me veprimet e ndërmarra në lidhje me botimin.

Matrica sugjeron përmirësimin e procesit përmes automatizimit dhe kjo do të ishte ideale në këtë situatë. Një sistem i automatizuar i menaxhimit të marrëdhënieve me klientin do të siguronte që të gjitha detajet e abonentit të ishin ruajtur dhe të disponueshme për të gjithë anëtarët e ekipit të marrëdhënieve me klientin. Në këtë mënyrë, çdo anëtar i ekipit do të jetë në gjendje t'i përgjigjet një pyetjeje të klientit me njohuri të plota dhe të merret menjëherë me çdo çështje. Ka shumë sisteme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët që ka të ngjarë të plotësojnë nevojat e kompanisë dhe duhet të sigurojnë që procesi të jetë i efektshëm.

Lista e pagave

Lista e pagave është një proces mjaft i drejtpërdrejtë, por departamenti i pagave duket se po e bën atë më kompleks se sa duhet. Ekzistojnë rregulla që nënkuptojnë se çdo aktivitet brenda këtij procesi duhet të jetë rutinë, edhe nëse ato nuk ndodhin në të njëjtën mënyrë për çdo anëtar të stafit.

Edhe pse është e rëndësishme që punonjësit të pagohen në shumën e duhur, në kohën e duhur, procesi i pagimit të stafit nuk është strategjikisht i rëndësishëm pasi nuk mund të

sigurojë avantazh konkurrues për kompaninë.

Prandaj matrica sugjeron që ky proces të kontraktohet ose automatizohet. Mund të ndodhë që të mos ekzistojë një sistem i përshtatshëm, i cili përfshin rregulla të ndryshme pagese. Nëse është kështu, atëherë Grupi Delta duhet të konsiderojë kontraktimin nga jashtë të listës së pagave, e cila do të menaxhojë procesin në mënyrë profesionale dhe gjithashtu duhet të përfitojë nga ekonomia e shkallës. Kjo mund të zvogëlojë koston për Delta grupin dhe duhet të heqë çdo demotivim të shkaktuar nga procesi aktualisht i gabuar.

(b) Grupi Delta tashmë ka vendosur të transferojë departamentin e tij ligjor, kështu që duhet të jetë i vetëdijshëm për disavantazhet dhe rreziqet e përfshira, në mënyrë që të përpiqet të menaxhojë ato rreziqe.

Shërbimet ligjore ka të ngjarë të jenë të kushtueshme, duke pasur parasysh nivelin e ekspertizës së kërkuar. Ofruesit e kontraktimit duhet të fitojnë një diferencë fitimi për shërbimet e tyre. Kështu, mundësia për kursime të përgjithshme të koston do të varet nga sa shpesh dhe për sa kohë, ky shërbim është i nevojshëm.

Është e mundshme që duhet të paguhet një tarifë vjetore, e cila mund të përfshijë ose jo të gjitha shërbimet.

Ekziston rreziku i rritjes së kostove në të ardhmen, nëse përdoret një kontraktor i vetëm, pasi mund të jetë e vështirë për Delta Grupin të kalojë te një ofrues tjetër në fund të periudhës së kontratës.

Ekzistojnë firma të shumta për tu zgjedhur dhe rreziku është që Delta Grupi të mos arrijë të zgjedhë ofruesin më të mirë për nevojat e tyre. Firmat ligjore ofrojnë një larmi shërbimesh dhe shpesh specializohen në fusha të veçanta. Nëse kompania nuk ka pasur nevojë për një shërbim specifik ligjor më parë, mund të ndodhë që ofruesi i tyre i zgjedhur nuk mund t'i plotësojë këto nevoja.

Shërbimet ligjore janë shumë konfidenciale, veçanërisht nëse grupi po shqyrton këshillat ligjore për artikujt që nuk janë botuar ende. Mund të shqetësohet që përmbajtja e artikujve të rrjedhë në një farë mënyre tek konkurrentët, veçanërisht nëse ata ndajnë të njëjtën kompani të jashtme.

Duke pasur parasysh ekspertizën e kërkuar, do të jetë e vështirë për grupin të kthejë këtë proces brenda kompanisë nëse kontraktimi i jashtëm nuk funksionon.

Kontraktimi i jashtëm gjithashtu mund të çojë në humbjen e kontrollit mbi cilësinë. Sidoqoftë, një firmë ligjore me qasje në shumë staf duhet të jetë e aftë të ofrojë një shërbim me cilësi të lartë, ndoshta me një cilësi më të lartë se një departament i vogël juridik brenda një kompanie.

Në mënyrë që të menaxhojë rrezikun e koston, Grupi Delta duhet të sigurojë që të ketë një marrëveshje plotësisht të rënë dakord për nivelin e shërbimit, e cila detajon gjithçka që përfshihet në tarifën e hollësishme për çdo shërbim shtesë.

Në mënyrë të ngjashme, marrëveshja e nënshkruar mund të përdoret për të siguruar që nuk ka rrezik për konfidencialitetin.

Rreziku që kontraktuesi të mos jetë në gjendje të përmbushë nevojat e tyre mund të tejkalohet

me një vendim për të kontraktuar një shumëllojshmëri të firmave ligjore kundrejt kontraktimit të një firme të vetme.

Problemi 3

Trimi, një prodhues i ëmbëlsirave dhe çokollatave, punësoi një grup konsulentësh (BTM) për të kryer një rishikim strategjik të ndërmarrjes. Trimi kërkoi që BTM të përqendrohet në sugjerimin e strategjive alternative për arritjen e rritjes. Pas rishikimit, Trimi planifikon të marrë vendimin e vet për atë strategji që do të ndjekë. Bordi i drejtorëve i shpjegoi BTM pse po kërkonin këtë rishikim, me arsyet e përmbledhura si më poshtë:

1. Kompania nuk ka arritur të rrisë pjesën e saj të tregut gjatë katër viteve të fundit, me pjesën e saj të luhatur me më pak se 1% çdo vit.
2. Fitimet kanë rënë gradualisht, pasi ka qenë e nevojshme të mbahen çmimet mjaft konstante për të ruajtur kërkesën. Sidoqoftë, kostot direkte dhe indirekte janë rritur.
3. Aksionarët po shqetësohen pasi dividendët kanë rënë dhe çmimi i aksioneve gradualisht po bie. Ata duan të shohin si dividendët ashtu edhe çmimin e aksioneve të përmirësuar nga një rritje e konsiderueshme në të ardhmen.

Si pjesë e rishikimit, BTM kreu një analizë SWOT, me gjetjet kryesore që tregohen në Tabelën 1.

<p style="text-align: center;">Përparësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trimi zotëron patenta për shumë receta, të vlefshme në vend - Gama e gjerë e produkteve me mbi 300 produkte - Trimi është lider në treg me një pjesë të tregut prej 46% të tregut të ëmbëlsirave - Përvoja e mëparshme e blerjes - Marketingu i fortë; 98% e banorëve të moshës 11+ janë të vetëdijshëm për markën Trimi - Ekip menaxherial me përvojë, mesatarisht 16 vjet punësim në Trimi - Zinxhir i mirë furnizimi, me produkte të shitura në të gjitha supermarketet kryesore përveç dyqaneve të vogla dhe gazetave 	<p style="text-align: center;">Mangësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Më pak se 3% e të hyrave vijnë nga produktet e reja çdo vit - Ekip i vogël për krijimin e produkteve, me shumicën e anëtarëve që po afrohen drejt pensionimit - Planifikimi i dobët - Procese shumë jo fleksibile të prodhimit, me linja të veçanta prodhimi - Asnjë përvojë e mëparshme e zgjerimit jashtë shtetit
